



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr- 410-45757

Me datë 04.09.2026

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", dispozitave të Ligjit Nr.10/L-022 për banim social dhe të përballueshëm, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 8/2026", nenin 30 dhe 45 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, e në mbështetje të nenit 5, të Udhëzimit administrativ Nr-22/2010, për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banim dhe Thirrjes publike nga Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqeni sociale, me datën 03.08.2026, me numër 06-Nr-901, Kryetari i Komunës, nxjerri këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit

1. Formohet komisioni për vlerësimin dhe përzgjedhjen e familjeve që kanë aplikuar në thirrjen publike për bonus banim të shpallur nga Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqeni sociale, me datën 03.08.2026, me numër 06-Nr-901, në këtë përbërje:
 - 1.1 Besmir IBALLI -----kryesues
 - 1.2 Shehide BYTYQI ---anëtare
 - 1.3 Mimoza BYTYQI-SADIKAJ-----anëtare
2. Detyrë e këtij komisioni është që të bëjë vlerësimin dhe shqyrtimin e aplikacioneve të aplikatëve që kanë konkurruar në thirrjen publike për bonus banim të shpallur nga Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqeni sociale, me datën 03.08.2026, me numër 06-Nr-901 dhe në bazë kritereve të përcaktuar në thirrjen publike dhe në bazë të kritereve të përcaktuar në Udhëzimin administrativ Nr. 21/2010 për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit dhe në fund ti përcaktojnë fituesit.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.

Kopje :
DSHMS-ja
Komisioni
Arkiva



Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ

PEANOI: